

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 2

Kodi: 066

TRAJNIMI I TRAJNERËVE PËR PUNË ME TË RRIKUR

Tipi i programit: Plotësues

Hyrje

KEC ka një përvojë mbi dydekadëshe në hartimin, zhvillimin dhe realizimin e programeve të ndryshme të trajnimit, duke kontribuar vazhdimisht në zhvillimin profesional të individëve dhe institucioneve në fusha të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe, KEC ka investuar jo vetëm në ofrimin e programeve cilësore të trajnimit, por edhe në ndërtimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të trajnerëve, duke e konsideruar zhvillimin e trajnerëve si një komponent thelbësor për garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së programeve trajnuese.

Bazuar në përvojën shumëvjeçare dhe nevojën e vazhdueshme për zgjerimin e kapaciteteve të trajnerëve, Programi për Trajnimin e Trajnerëve është zhvilluar si një komponent i rëndësishëm i sistemit të sigurimit të cilësisë së KEC. Përmes këtij programi janë përgatitur dhe zhvilluar trajnerë të aftë për të mbështetur realizimin e programeve të ndryshme të trajnimit dhe për të kontribuar në përmbytjen e standardeve të cilësisë së KEC.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij trajnimi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin 16 standardet e trajnerit të KEC;
- Të njohin parimet themelore të të nxënësve tek të rriturit dhe elementet kryesore të andragogjisë;
- Të njohin me metoda të ndryshme për t'i mbajtur aktive sesionet e trajnimit;
- Të përdorin mjete dhe teknika të cilat e bëjnë trajnerin të suksesshëm;
- Të kuptojnë dallimin midis lehtësisë të të nxënësve dhe formave të ligjërit;
- Të kuptojnë rëndësinë e punës ekipore si dhe të demonstrojnë aftësi ndërpersonale dhe të përshtatshme për të punuar me të rriturit;
- Të ushtrojnë shkathtësitë e të dëgjuarit dhe të të pyeturit, si dhe të reflektojnë mbi rolin e tyre në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe bashkëpunues;
- Të tregojnë aftësi në planifikimin e përmbajtjes së trajnimit si dhe anës logjistike;
- Të përgatisin Planin për demonstrimin e aftësive dhe shkathtësive të trajnerit;
- Të demonstrojnë në grup aktivitete për një temë të caktuar, me qëllim të vetëvlerësimit;
- Të demonstrojnë se e kanë kuptuar lidhjen ndërmjet parimeve të të nxënësve dhe praktikave të mësimdhënies, të cilat përbëjnë thelbin e të nxënësve aktiv.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 2

Përmbajtja

Parimet themelore dhe të avancuara të të nxënies të të rriturit dhe të andragogjisë; standardet e trajnerit të KEC; çfarë i nevojitet një trajneri për të qenë i suksesshëm; karakteristikat e një trajneri të mirë; strategjitë bazë të trajnerit për t'iu përshtatur inteligjencave të shumëfishta; aktivitetet për thyerjen e akullit dhe shkëmbimin e mendimeve; puna në grupe; zgjidhja e konflikteve; të dëgjuarit aktiv dhe të pyeturit; barazia gjinore; si dhe vlerësimi i demonstrimit të shkathtësive të trajnerit.

Grupi synuar

Ky program u dedikohet personave të cilët pritet të ofrojnë programe të ndryshme trajnimi për të rritur.

Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi organizohet në formën e një trajnimi treditor. Gjatë ditës së tretë të trajnimit, pjesëmarrësit, të organizuar në çifte ose grupe, përgatisin materiale dhe demonstrojnë aftësitë e tyre si trajnerë. Ky aktivitet shërben për vlerësimin e nivelit të përgatitjes së tyre për rolin e trajnerit.

Programi për përgatitjen e trajnerëve ka një kohëzgjatje prej 18 orësh.

Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen për gjithsej 18 orë trajnimi të drejtpërdrejtë.

Kriteret për certifikim janë:

- pjesëmarrja aktive në së paku 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- vlerësimi pozitiv i materialeve të përgatitura dhe të demonstruara gjatë ditës së tretë të trajnimit.